

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Udhese / Izlazje: Date / Dana: 02/02/2026		
Nr. Orgu Org. no: 01	Nr. Prot. Br. Prot. 20	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.20
 Data: 30.01.2026

Në bazë të nenit 61 pika 61.2 dhe 61.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.4 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026 miratoi këtë:

**VENDIM
 PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE**

I

Për Nënkyetar të Komunës nga radhët e komunitetit emërohet z.Jeton Emini.

II

Nënkyetari për komunitete emërohet për mandat të njejtë si të Kryetarit të Komunës.

III

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Dalese / Izlaze: Date / Dana: 021 021 2026		
Nr. Orgj. Org. Id.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqeve. Br. Strana.
01	21	8

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.21
Data: 30.01.2026

Bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, neni 40 paragrafi 40.2 pika d i Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale, dispozitat e nenit 25, paragrafi 2 pika 2.4 i Statutit të Komunës Ferizaj, 01.Nr.50 të datës 28.06.2013 dhe grupit punues për Hartimin e Planit Vjetorë të Punës së Kuvendit të Komunës për Vitin 2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026 mori këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETORË TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË FERIZJAT PËR VITIN 2026

I

MIRATOHET: Plani Vjetorë i Punës së Kuvendit të Komunës Ferizajt për Vitin 2026.

II

Plani vjetorë i cekur në pikën I të këtij vendimi përmban numrin: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahen mbledhjet e KK-së dhe pikat-temat orjentuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III

Plani Vjetorë i Punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në nenin II të këtij vendimi është pjesa tabelare shtojcë e këtij vendimi.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Ferizaj.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 25, paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Ferizajt, 01. nr. 50 të datës. 28.6.2013, dhe propozimit të Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, Grupi punues i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2026, miratoi:

PLANI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

Zyra e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Ferizajt

I

Plani vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt

II

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij Draft- Plani, pëmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III

Plani Vjetorë i Punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II e këtij Draft- Plani është si në vijim në formë tabelare

Muaji	Pikat e Rendi	Pershkrimi	Ora dhe vendi	Hartuesi	Propozues	Shqyrtton	Miraton	
Janar 2026	1	Propozim-Vendim për miratimin e Orarit të mbledhjes së seancave të Punës së Kuvendit të Komunës	10 -salla e KK	Kuvendi i Komunës	Kryesuesi	KPF	Kuvendi	
				Raportim i Drejtorit të DSHPE-së lidhur me menaxhimin e gjendjes gjatë dhe pas të reshurave.	Kuvendi i Komunës	Kryesuesi	KPF	Kuvendi
				Propozim-Vendim për ndarjen e subvencioneve në lëmin e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Kryetari i Komunës	KPF	Kuvendi
				Propozim-Vendim per dhenien ne shfrytezim te pronave	Drejtoria për Prona dhe Gjeodezi,	Kryetari i Komunës	KPF	Kuvendi i Komunës
				Raportim i Drejtorisë së Arsimit lidhur me gjendjen e shkollave në gjysmë-vjetorin e dytë. Përgatitjet teknike.				
Shkurt 2026	1	Propozim – Vendim për bartjen e mjeteve veranake nga viti 2025 në vitin 2026 (Nëse ka);		Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	KPF	Kuvendi i Komunës	
				2	Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën TM4 tetor –dijetor 2025;			

Mars 2026						
3	Seancë solemne me 17 Shkurt, për nder të Pavarësisë së Kosovës		KK	Kryesuesi i Kuvendit	KPF	Kuvendi i Komunës
4	Informatë nga Këshilli Komunal i Bashkësisë për Siguri KKBS		KK	Kryesuesi i Kuvendit	KPF	Kuvendi i Komunës
1	Vizitë zyrtare e anëtarëve të Kuvendit të Komunës		KK	Kryesuesi i Kuvendit	KPF	Kuvendi i Komunës
2	Informatë rreth gjendjes së Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale		Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
3	Bartja e buxheut të pashpënuar nga Viti 2025 në Vitin 2026;	10-salla e KK	Drejtoria e Financa	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
4	Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës – Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për Vitin 2025;		Drejtoria e Financa	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
5	Raportimi i komisioneve komunale të aksionarëve të NPL - ve për Vitin 2025; KRM''Pastërtia'' SH.A. NPL''Ambienti''SH.A. NPT''Stacioni i Autobusëve'' SH.A		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
6	Informatë për sigurinë në shkollat e Komunës;		Drejtoria e Arsimit	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
7			Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës

	3	Miratimi i akteve komunale në pajtim me obligimet e komunave që kanë ndaj ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të tjera që zbatohen në pushtetin lokal;		Zyra Ligjore	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
	4	Shqyrtimi i Raportit Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;	10-Salla e KK	Drejtoria e Auditimit	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
	5	Informatë rreth vërshtimeve atmosferike, mirëmbajtja e lumënjëve dhe kanaleve të ujit	10-Salla e KK	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
	1	Seancë Solemne 28 NËNTORI	10-Salla e KK	KK	Zyra e Kuvendit të Komunës	KPF	Kuvendi i Komunës
	2	Publikimi i pronave Komunale		Drejtoria për Prona dhe Gjeodezi	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
	3	Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror ne Institutionet publike ne Ferizaj ;		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
	1						
	2	Miratimi i planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027;	10 -salla e KK	Grupet parlamentare	Zyra e Kuvendit të Komunës	KPF	Kuvendi i Komunës
	3	Harmonizimi i akteve normative me legjislationin në fuqi		Zyra Ligjore	Zyra e Kryetarit	KPF	Kuvendi i Komunës
Dhjetor 2026							
Nëntor 2026							

	Raporti gjashtëmuji i të dytë i Kryetarit të Komunitetit për situatën ekonomiko-financiare të Komunitetit dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunitetit;	10 - salla e KK e KK	Zyra-Kabineti i Kryetarit	Kryetari I Komunitetit	KPF	Kuvendi i Komunitetit
5	Publikimi i listës së pronave të cilat jepen në shfrytëzim në Vitin 2027.	10 - salla e KK	Zyra-Kabineti i Kryetarit	Kryetari I Komunitetit	KPF	Kuvendi i Komunitetit

Data: 30/01/2026 /
Ferizaj


 Kryesuesi i KK-së

 Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datë / Izlaze: Date / Dana: 02.02.2026		
Nr. Org. / Org. no: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 22	Nr. Faqeve. / Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.22
Data: 30.01.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 12, si dhe nenit 58 pika 1.h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me numër 03/L-040, neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt me Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2026 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJËS SË BASHKËPUNIMIT DHE
BASHKËFINANCIMIT MES KOMUNËS SË FERIZAJT DHE CARITAS KOSOVA**

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt e që evidentohet me Nr.05/26 e datës 12.01.2026 që është marrëveshja e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosova.

II

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin dhe bashkëfinancimin dhe synon drejtpërdrejt rriten e punësueshmërisë së të rinjëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. Ky projekt ka vlerë të përgjithshme prej 138.175€, ku projekti "Your Job" i Caritas Kosova financon 66%, ndërsa Komuna e Ferizajt kontribuon me 44%.

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi do të jetë edhe marrëveshja në mes Kryetarit të Komunës si dhe përfaqësuesve të Caritas Kosova.

IV

Kjo marrëveshje prodhon efekt juridik 2 vite nga momenti i lidhjes së saj

V

Për zbatimin e kësaj marrëveshje përkujdeset Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

